

Fjalim i deputetes Klotilda Bushka

03.07.2023

Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuara kolege e kolegë deputetë,

Sot ka qenë një ditë shumë e rëndësishme. Të gjithë i kanë sytë te drejtësia, por më shumë se sytë ne duhet të kishim mendjen tek ajo që është pjesë e rendit të ditës sot. Drejtësia është e të gjithëve dhe reforma në drejtësi është e shqiptarëve. Kjo reformë ka kërkuar një vullnet të fortë politik për ndryshime kushtetuese, pa diskutim, dhe është e sigurt se pa PS-në nuk do të bëhej ajo reformë. Është e kotë të mbani sot fjalime nga mëngjesi në darkë, sepse kur keni qenë në pushtet, mund ta kishit bërë këtë reformë para se të vinte PS-ja.

Sot fjalimet që anatemojnë institucionet e drejtësisë, rezultatet e drejtësisë apo diskutimet që unë dëgjova rëndom, nuk i përkasin fare asaj që duhet të ndodhte realisht këtu. Reforma në drejtësi nuk është më një teori apo një realitet juridik, është një realitet ligjor faktik. Sot po zbatohet reforma në drejtësi, i ka ndërtuar themelet dhe i ka të forta; ka sfida, ka problematika, pa diskutim, se askush nuk tha që kjo rrugë do të ishte e lehtë, se e shohim edhe sot se sa shkopinj nën rrota përpiqen të fusin edhe në përditshmëri për zbatimin e reformës në drejtësi. Reforma në drejtësi është nevojë për shqiptarët. Kjo ishte arsyeja pse u bë kjo reformë, dhe jo vetëm, por i hapi rrugën procesit të integritetit në BE. Në fakt, edhe marrëdhënia e Kuvendit me institucionet e reja të drejtësisë është e normuar në Kushtetutë dhe në ligje, është një marrëdhënie e qartë se deri ku është roli që ka Kuvendi në këtë raport.

Roli ynë është t'i dëgjojmë të paktën një herë në vit institucionet për gjendjen e sistemit gjyqësor, për gjendjen e sistemit të prokurorisë, për rezultatet e punës së tyre dhe bashkë të vendosim rekomandime, por ne nuk mund t'u japim rekomandime institucioneve që të zbatojnë ato që parashikon ligji. Ne këtu duhet të jemi sytë e publikut, se kemi si qëllim ta informojmë atë për drejtësinë, se cilat janë realisht rezultatet e saj, sfidat e saj dhe si mund të bëhet më mirë. Publiku e sheh përditë, e kupton që drejtësia po jep rezultate në lidhje me zhdukjen e kulturës së pandëshkueshmërisë, një nga kushtet themelore të reformës në drejtësi. Rezultatet janë të qarta. A ka ende punë në këtë drejtim? Pa diskutim! Ama ka disa çështje që ne, si përfaqësues të popullit, në emër të publikut, në emër të pritshmërive të drejta të publikut te drejtësia, duhet t'i ngremë dhe t'i japim si rekomandime. Këto kemi bërë në Komisionin e Ligjeve, ku kemi dëgjuar me orë të tëra në seanca dëgjimore shumë serioze përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë, nga të cilët jemi informuar për situatën reale të sistemit dhe për nevojat që ka, kemi diskutuar pritshmëritë që ka publiku, duke i përkthyer në rekomandime dhe jo më kot e bëmë këtë seancë të përbashkët për të gjitha institucionet e drejtësisë, pasi doli një nevojë nga të gjitha këto dëgjesa, për vitin e dytë radhazi.

Ka një mungesë të koordinimit të institucioneve, dhe ato nuk janë ishuj, por i shërbejnë të njëjtit qëllim. Duke i dëgjuar të gjithë përfaqësuesit e institucioneve në komision, arritëm në konkluzionin se ka rekomandime që mund të vlejshëm për secilin.

E tha edhe njëri nga kolegët e mi sot që prokurori i Përgjithshëm pranoi se ka prokurorë që zbatojnë standarde të ndryshme, dhe kjo çështje duhet të adresohet patjetër, edhe me institucionet e tjera, siç është Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, po ashtu dhe rekomandimet e Kuvendit, të cilat disa i nënvlerësojnë. Një rekomandim i tillë ka qenë në rezolutën e vjetshme edhe për ILD-në, për prokurorin e Përgjithshëm dhe për KLP-në, dhe ka një rezultat konkret këtë vit nga raportimi. Udhëzimet me karakter të përgjithshëm, që i nxjerr prokurori i Përgjithshëm dhe janë të detyrueshme të zbatohen nga prokurorët e të gjitha niveleve, këtë vit kanë zbatueshmërinë më të lartë, sepse ka qenë një rekomandim që institucionet të koordinojnë se si të marrin masa në këtë drejtim. Për çfarë ishin ato rekomandime? Ishin për luftën kundër kriminalitetit.

Sot duhet bërë analiza në bazë të raporteve që sjellin institucionet, të cilat janë me qindra faqe. Unë do të doja t'i falënderoja shërbimet e monitorimit në Kuvend për rezymetë që kanë bërë, për analizat jo vetëm statistikore, por edhe cilësore për të kuptuar rezultatet, si dhe të gjithë deputetët në komision, të të gjitha kaheve, pa dallim, që u angazhuan seriozisht për të kuptuar nevojat e sistemit, për të kuptuar rezultatet dhe për të parë se çfarë mund të bëjnë më mirë. Para se të japim mend apo të anatemojmë drejtësinë, kolegë, a mund të bëjmë detyrën tonë, a mund të bëjmë atë që na dikton Kushtetuta dhe ligji, a mund të bëjmë këtë analizë, që na e lë si përgjegjësi kuadri ligjor që është miratuar këtu, nga ky Kuvend? Që të bëjmë këto duhet të merremi me disa çështje kyçe.

E para është meritokracia. Sot është fakt që KLGJ-ja dhe KLP-ja bëjnë emërimet në sistem në bazë të kriterëve të meritokracisë.

Në këtë moment gjej rastin t'u bëj thirrje të gjithë avokatëve dhe atyre që përfaqësojnë shoqërinë civile, duke qenë se një pjesë e këshillave do të rinovohen, pasi mandatet e atyre që vijnë nga radhët e avokatisë dhe të shoqërisë civile do të përfundojnë në fund të vitit, që të jenë të interesuar dhe të marrin pjesë në thirrjet që Kuvendi hap për pak ditë, për t'u bërë pjesë e këtyre këshillave, duke uruar që të rinjtë që do të vijnë do të ruajnë të njëjtat standarde dhe do t'i përmirësojnë ato në drejtim të forcimit të të gjithë mekanizmave, për të vënë më të mirët në sistemin e prokurorisë dhe në atë gjyqësor.

E dyta është pavarësia. Kemi bërë një sistem krejtësisht të pavarur të drejtësisë, por me kompetenca të kufizuara për të ndaluar ndërhyrjet e padrejta të politikës dhe të të gjitha pushteteve të tjerë në drejtësi. Siç thuhet edhe në raportin më të fundit të Komisionit të Venecias, sa më shumë pavarësi t'i jepet një institucioni, aq më tepër një institucioni apo një sistemi të drejtësisë, aq më shumë duhet të rritet llogaridhënia. Llogaridhënia në sistem është e përcaktuar qartë. Ne do të duhet të flisim sot se si ka qenë puna në drejtim të llogaridhënies së brendshme dhe të forcimit të kontrollit të brendshëm të sistemit të drejtësisë në shohim në sy të vërtetat,

rezultatet dhe arritjet, sfidat dhe problematikat. Ne e kemi për detyrë të jemi pjesë e zgjidhjes, jo t'i drejtojmë gishtin njërit apo tjetrit.

E katërta është krimi kibernetik. Sot institucionet e drejtësisë kanë nevojë të fuqizojnë kapacitetet për të luftuar krimin kibernetik, si dhe krimet ndaj të miturve në internet. Do të duhet që ata të fokusohen në këtë drejtim, e kanë mbështetjen tonë për kapacitete të tjera dhe ne do t'ua japim, se e kemi për detyrë, ashtu sikurse në kuadër të kontrollit parlamentar, për aq sa na e lejon ligji, duhet të kërkojmë që të kenë prioritete në punën e tyre, ku, pa diskutim, kryefjalë duhet të jenë eficientia, llogaridhënia, transparenca me publikun, rritja e profesionalizmit në sistem, vijimi i procesit të emërimeve në bazë të meritokracisë dhe vijimi i rezultateve të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Të gjitha zyrat e prokurorisë, si ato të zakonshmet, ashtu dhe ato të posaçme duhet të forcojnë kapacitetet për të respektuar garancitë procedurale, duhet të kenë rezultate sipas fushës së tyre të veprimtarisë, por duke respektuar në të njëjtën kohë të drejtat e njeriut, parimin e proporcionalitetit dhe shumë garanci të tjera procedurale, si barazinë para ligjit, me qëllim që një grua të mos rrijë në burg se u kap për shitjen e 1 grami hashash dhe një burrë të dalë nga burgu, pra dy masa arresti të ndryshme. Ka ardhur koha që prokuroritë dhe gjykatat tona të unifikojnë standardet për t'u dhënë drejtësi të barabartë të gjithë shqiptarëve.

Në fund, unë do të doja të falënderoja të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e ndershëm dhe me integritet në këtë vend, të cilët po mbajnë një ngarkesë shumë më të madhe se më parë dhe uroj që të gjitha masat, që duhen marrë këtë vit, të cilat janë detyrim në progresraport sa i takon uljes së stokut nëpër gjykata dhe lehtësimit të punës së tyre, të japin rezultate konkrete!

Nga ana tjetër, do të doja të falënderoja institucionet e drejtësisë, sepse kanë pasur një angazhim shumë serioz në përmbushjen e të gjitha rekomandimeve të progresraportit të BE-së për Shqipërinë! Të vijojnë punën në këtë drejtim, duke i zbatuar me përpikëri të gjitha rekomandimet, se nuk janë rekomandime vetëm për t'u bërë pjesë e familjes së madhe europiane, ku ne aspirojmë të jemi, por u shërbejnë interesave të qytetarëve shqiptarë dhe do të duhet t'i kenë në konsideratë në punën e tyre çdo ditë.

Në mbyllje të fjalës sime do të falënderoj të gjithë kolegët deputetë që votuan me unanimitet në komision rezolutat e të gjitha institucioneve të pavarura!

Ju ftoj të gjithëve t'i miratoni!

Nëse keni ide se si mund ta përmirësojmë këtë gjë, ju lutem, bëhuni pjesë e zgjidhjes dhe mos rrinë mënjane, duke anatemuar punën e të tjerëve!